



Biografi e shkurtër

Ilir Kadiu, Këshilltar Ligjor

Z. Ilir Kadiu është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2011 është diplomuar me titullin “Master në të Drejtën Administrative” në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit Evropian të Tiranës. Në vitin 2013 ka marrë titullin “Auditues në sektorin publik” nga Ministria e Financave.

Pas diplomimit ka punuar si koordinator ligjor për projekte të organizatave ndërkombëtare të financuara nga UNHCR, ICMC dhe USAID.

Në vitin 2006 ka punuar si Jurist në Kontrollin e Lartë të Shtetit në Departamenti Juridik. Ka një eksperiencë 5-vjecare në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Kryeministri. Në vitin 2013 emërohet në detyrën e Kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vitin 2004 ka marrë titullin “Avokat”, anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë. Ka ushtruar profesionin e Avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, kryesisht në çështje administrative dhe civile.

Gjatë eksperiencës së tij të punës ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me procedurat e kontrollit administrativ, në fushën e antikorrupsionit si dhe nëpunësin civil. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe atë italiane.

Aktualisht ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.